LIGJ
Nr.9422, datë 29.9.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BANKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR ASISTENCË FINANCIARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për asistencë financiare", në shumën 9 000 000 (nëntë milionë) euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4671, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN SI HUADHËNËS, SHQIPËRISË SI HUAMARRËS DHEBANKËS SË SHQIPËRISË SI AGJENT I HUAMARRËSIT

Kjo Marrëveshje Huaje (Marrëveshja) është bërë 9 000 000 euro midis Komunitetit Europian, në vijim i referuar si "KE" ose "Huadhënësi", i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, në vijim i referuar si "Komisioni", në emër të të cilit vepron z.Joaquin Amunia, anëtar i Komisionit, dhe Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si "Shqipëria" ose "Huamarrësi", i përfaqësur nga z.Arben Malaj, Ministër i Financave të Shqipërisë dhe Bankës së Shqipërisë, e cila vepron si Agjente në emër të Huamarrësit, në vijim referuar si "Agjent", përfaqësuar nga z.Ardian Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

Hyrje

Duke pasur parasysh se autoritetet kanë kërkuar asistencë të mëtejshme nga KE-ja,

Duke pasur parasysh se Këshilli i Komunitetit Europian, në vijim referuar si "Këshilli", me anë të vendimit të tij 2004/580/KE të datës 29 prill 2004 (Vendimi), ka vendosur të sigurojë asistencë makro-financiare për Shqipërinë, duke dhënë një hua në shumën maksimale prj 9 milionë euro për të ndihmuar vendin që të përmbushë nevojat financiare të huaja, përfshirë fuqizimin e rezervave dhe mbështetjen buxhetore,

Duke pasur parasysh se Këshilli ka autorizuar Komisionin të bjerë dakord me autoritetet e Huamarrësit, pas konsultimit me Komitetin Ekonomik dhe të Financave, kushtet e politikave ekonomike që i bashkëngjiten asistencës financiare,

Duke pasur parasysh se Komisioni është konsultuar me Komitetin Ekonomik dhe të Financave për këto kushte,

Duke pasur parasysh se autoritetet e Huamarrësit kanë ndërmarrë angazhimin për të përmbushur

kushtet e parashikuara nga asistenca makro-financiare, ashtu siç është rënë dakord me Komisionin në një memorandum mirëkuptimi (në vijim referuar si Memorandumi), që i bashkëngjitet dhe që është një pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje,

Duke pasur parasysh se Komisioni është autorizuar për të marrë hua burimet e nevojshme në emër të KE-së,

Duke pasur parasysh se në përputhje me dispozitat e vendimit, kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe të memorandumit, huaja në shumën 9 milionë euro do të mundësohet për Shqipërinë në një transh të vetëm në përputhje me dispozitat e memorandumit dhe të kushteve të kësaj Marrëveshjeje,

Duke pasur parasysh se në zbatim të kësaj huaje, Komisioni, në emër të KE-së, pas Marrëveshjes me Huamarrësin për kushtet kryesore financiare (që do të thotë norma e interesit, shumat e përafërta neto, maturimi), do të emetojë një obligacion për shumën totale të principalit prej 9 milionë euro, ose për ndonjë transaksion tjetër të përafërt financiar, shumat e të cilave do t'i huazohen Shqipërisë dhe do të disbursohen në një llogari, që Shqipëria do ta hapë me Agjentin ditën kur të jenë marrë nga Komisioni (data e pagesës) dhe Huadhënësi do të bëjë përpjekjet më të mira për ta marrë atë sipas gjykimit të vet sipas kushteve më të mira të disponueshme të tregut për transaksionet në fjalë. Ndërsa një kopje e çdo kontrate lidhur me emetimin e obligacionit të lartpërmendur ose të çdo transaksioni tjetër financiar të duhur, në vijim referuar si "Kontratat e huamarrjes" do t'i bashkëngjiten si anekse, duke pasuar ekzekutimin e secilës në lidhje me Marrëveshjen dhe do të formojnë një pjesë përbërëse të saj, ashtu siç është parashikuar këtej e tutje.

Për sa më sipër, palët kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Vlera e huasë

Huadhënësi do të bëjë të mundur për Huamarrësin huanë prej 9 milionë euro, shumën kryesore (huaja) në një transh, subjekt i afateve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin, në këtë Marrëveshje dhe në memorandumin bashkëngjitur.

Neni 2

Të ardhurat neto, tërheqjet dhe kushtet paraprake

1. Shumat neto (në vijim referuar si shumat neto) të huasë do të jenë të barabarta me shumat neto të një ose më shumë transaksioneve financiare që KE është përfshirë për të financuar huanë (transaksionet financiare) minus shumën totale të kostove dhe të shpenzimeve lidhur me transaksionet financiare dhe përgatitjen, dhe ekzekutimin e transaksioneve të tilla nga huaja.

2. Shumat neto të huasë, siç parashikohet në paragrafin e mëparshëm, do të transferohen në datën e pagesës në llogarinë bankare euro të Agjentit, me numër 100 92 12 15 000 pranë Deuttsche bank, Frankfurt am Main, SWIFT code: Deutdeff, ose në ndonjë llogari tjetër euro të sugjeruar me shkrim ndaj Huadhënësit nga Agjenti të paktën 6 ditë-punë para datës së pagesës. Nëse fondet transferohen te buxheti, Ministria e Financave dhe e Thesarit të Shqipërisë dhe Agjenti do t'i japin Komisionit një njoftim zyrtar mbi transferimin e ekuivalentit të shumës në monedhë lokale të mbajtur në llogarinë e Agjentit.

3. Detyrimi i KE-së, për të tranferuar shumat neto për te Huamarrësi lidhur me Huanë, do t'i nënshtrohet:

1. Marrjes nga Komisioni të të paktën dy ditëve punë Luksemburgu përpara datës në të cilën KE-ja ka ndërmend të kryejë transaksione financiare për huanë, një datë e tillë do t'i komunikohet përpara Humarrësit, të opinioneve ligjore të arsyeshme dhe të pëlqyeshme të dhëna për Komisionin nga: a) Z.Fatmir Xhafa, Ministër i Drejtësisë i Shqipërisë ose një nga zëvendësit e tij dhe b) Z.Dominico Apicella nga Studio Ligjore Tonucci ose nga ndonjë këshilltar ligjor i pavarur për Huadhënësin. Këto mendime ligjore duhet t'i përkasin një date jo më të hershme sesa data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, ashtu siç përcaktohet në nenin 12, dhe jo më vonë se dy ditë-punë Luksemburgu përpara datës në të cilën KE-ja ka ndërmend të kryejë transaksionin financiar dhe duhet të shpallë në respektim të ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve të detyrueshme ligjërisht, aktualisht të zbatueshme në vendin e Huamarrësit. Huamarrësi gjatë ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje përfaqësohet nga Z.Arben Malaj, Ministër i Financave, i zotuar rregullisht dhe e parevokueshme për të përmbushur detyrimet që parashikohen nga kjo Marrëveshje.

Huamarrësi dhe Agjenti zotohen të informojnë Huadhënësin, menjëherë, nëse ndërmjet datës së mendimit ligjor sipas a) më sipër dhe datës së transaksionit financiar, një datë e tillë t'i komunikohet Agjentit nga Huamarrësi dhe datës së transaksionit financiar ndodh ndonjë ngjarje që mund të bëjë jo të sakta çdo deklaratë të bërë në opinionet ligjore.

2. KE nga njëra anë dhe një bankë ose sindikatë e bankave në anën tjetër, pasi kanë nënshkruar kontratat e huamarrjes të paktën dy ditë-punë përpara datës së pagesës dhe pasi KE-ja të ketë marrë në ditën e pagesës shumat neto të transaksionit financiar nga banka në fjalë ose sindikata e bankave.

3. Nëse nuk ka ndodhur anjë ndryshim i pafavorshëm material që nga data e ekzekutimit të Marrëveshjes që, sipas mendimit të Huadhënësit, pas konsultimeve me Huamarrësin, ka shumë të ngjarë të ekzistojë mundësia për të paragjykuar materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij të pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje p.sh., për të bërë të mundur shërbimin e huasë dhe shlyerjen e saj.

Neni 3

Gjendja dhe zotimet

1. Huaja sipas kësaj Marrëveshjeje do të përbëjë një detyrim të pasiguruar, direkt dhe të pakushtëzuar dhe të përgjithshëm për Huamarrësin dhe do të ketë epërsi *pari passu* ndaj të gjitha huave dhe detyrimeve të pasiguruara të tanishme dhe të ardhshme të Huamarrësit që rrjedhin nga borxhi i jashtëm i tanishëm dhe i së ardhmes, ashtu siç parashikohet në nenin 8 paragrafi 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huamarësi merr përsipër, deri në kohën kur i gjithë principali sipas kësaj huaje është rimbursuar plotësisht dhe të gjitha interesat, si dhe shumat shtesë nëse ka të tilla sipas huasë janë paguar plotësisht dhe me përjashtim të barreve të renditura në paragrafin 3 të nenit 3, të mos sigurojë hipotekë, peng ose çdo barrë në pasuritë e tij ose të ardhurat, të çdo borxhi të jashtëm aktual ose të ardhshëm dhe çdo garancie ose dëmshpërblimi të dhënë në lidhje me këtë, përveçse kur huaja ka epërsi *pari passu* dhe *pro rata* në sigurinë e dhënë. Huamarrësi merr përsipër gjithashtu të mos kërkojë riskeduimin e huasë ose të ndonjë lehtësimi borxhi në lidhje me huanë ose çdo hua të mëparshme të dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi, me përjashtim të borxheve të parashikuara sipas paragrafit 3 të këtij neni, si dhe nuk do t'i jepet asnjë kreditori tjetër përparësi sipër Huadhënësit.

3. Humarrësi, në respektim të zotimit të tij sipas paragrafit 2, mund të lejojë vetëm barrat në vijim:

1) Barrat mbi çdo pronë të vënë për të siguruar marrjen e çmimit të kësaj prone dhe çdo ripërtëritje dhe zgjatje e kësaj barre, e cila kufizohet me pronën origjinale të mbuluar nga ajo dhe e cila siguron çdo ripërtëritje ose zgjatje të financimit të siguruar;

2) Barrat mbi të mirat tregtare të rrjedhin nga zhvillimi i transaksioneve bankare tregtare të zakonshme (dhe që skadojnë tek e fundit brenda një viti në vijim) për financimin e importimit ose eksportimit të këtyre të mirave në ose nga vendi i Huamarrësit; dhe

3) Barrat që sigurojnë ose mundësojnë pagesën e borxhit të jashtëm, i marrë vetëm për të mundësuar financim për projekte të arsyeshme dhe të mirëpërcaktuara të investimit, parashikojnë që pronat ndaj të cilave këto barra zbatohen janë prona të cilat i nënshtrohen financimit të këtyre projekteve ose të cilat janë të ardhura ose pretendime që rrjedhin nga projekti;

4) Çdo barrë tjetër që ekziston prej kësaj date, të parashikuara që këto barrra do të ngelen të lidhura me pronat mbi të cilat ato rëndojnë dhe pronat mbi të cilat rëndojnë këto barra sipas kontratave në fuqi në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të parashikuara më tej që këto barra sigurojnë ose mundësojnë pagimin e vetëm të këtyre detyrimeve të siguruara ose të parashikuara për në datën në vijim ose çdo rifinancim të këtyre detyrimeve;

5) Të gjitha barrat e tjera ligjore dhe privilegjet, të cilat veprojnë vetvetiu nga ligji, të cilat nuk mund të evitohen në mënyrë të arsyeshme nga Huamarrësi. Ashtu siç është përdorur në këtë paragraf, financim i një projekti nënkupton çdo financim ose përvetësim, ndërtim ose zhvillim të çdo prone në lidhje me një projekt nëse entiteti që mundëson një financim të tillë shprehet dakord për të parë pronat e financuara dhe të ardhurat e nxjerra nga veprimi i, ose humbja, ose dëmtimi i këtyre pronave si burimi kryesor i shlyerjes për paratë e kaluara.

Neni 4

Interesi

1. Norma e interesit mbi huanë dhe datat e duhura për pagesat e interesit do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në nenet përkatëse të kontratave të huamarrjes. Në rastin e një norme të interesit të ndryshueshëm, kjo normë nuk do të jetë më e madhe se 6 muaj euribor plus 0.20% në vit, dhe Huadhënësi do të këshillojë Agjentin të paktën një muaj përpara datës përkatëse të shumës së interesit përkatës dhe të pagueshëm në datën në fjalë dhe të detajeve (norma e interesit, periudhë interesi) mbi të cilat bazohet llogaritja e interesit. Në rastin e një norme interesi fiks, kjo normë nuk do të jetë më e lartë se 6.00% në vit. Nëse Huadhënësi, për shkak të kushteve mbizotëruese të tregut në kohën e emetimit të një obligacioni ose të çdo transaksioni tjetër financiar nuk është në gjendje për të marrë fondet poshtë ose sipër maksimumit të normave të interesit, atëherë Huadhënësi nuk ka asnjë detyrim për të bërë të mundur ndaj Huamarrësit

shumat neto të huasë dhe në bazë të kërkesës nga Huamarrësi, Huadhënësi do t'i propozojë Huamarrësit të negociojnë normat e reja maksimale të interesit në kuadër të kushteve mbizotëruese të tregut.

2. Sipas kërkesës së Huamarrësit dhe nëse sipas gjykimit të Huadhënësit rrethanat lejojnë një përmirësim të normës së interesit të huasë, Huadhënësi mundet që, në përputhje me nenin 5 paragrafi 3 të vendimit, të riformulojë kushtet financiare të huamarrjeve të Huadhënësit, kur parashikohet që kontratat përkatëse të huamarrjes lejojnë një riformulim të tillë ose që Huadhënësi mund të diskutojë kontratat e huamarrjes.

3. Nëse shumat neto të huasë nuk mund të transferohen në datën e pagesës për çdo arsye tjetër veç atyre të përmendura në nenin 2 paragrafi 3(3), atëherë Huadhënësi do t'i depozitojë këto shuma në vlerën më të mirë të disponueshme të tregut për depozitë me afat dhe, pa vonesë, të lajmërojë Agjentin mbi këtë fakt dhe mbi normën e interesit të përfituar. Interesi i marrë nga Huadhënësi mbi këtë depozitë do të zbritet nga pagesat e interesit të duhura dhe të pagueshme nga Huamarrësi.

4. Nëse Huamarrësi dështon në pagimin e principalit ose të interesit të pagueshëm sipas kësaj Marrëveshjeje në datën e caktuar, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit interes shtesë mbi këto shuma (ose, nëse është rasti, shumën në vijim nga koha kur kjo është bërë e pagueshme dhe nuk është paguar) nga data përkatëse deri më datën aktuale të pagesës, e llogaritur në mënyrë të plotë, duke iu referuar periudhave të interesit pasues (çdo kohëzgjatje e tillë, për sa kohë Huadhënësi mundet që nga koha në kohë të përzgjedhë, periudhën e parë ta fillojë në datën e lidhur dhe kur është e mundur, kohëzgjatja e kësaj periudhe do të jetë një javë) më të lartë se:

a) norma për një vit si shumë totale e:

i) një për qind (1 për qind) në vit dhe

ii) vlera euribor për kohëzgjatjen përkatëse ose

b) një për qind (1%) në vit plus normën e interesit të huasë, ashtu siç përcaktohet nga neni 4 paragrafi 1.

Përsa kohë vazhdon dështimi për të paguar, një normë e tillë do të rivendoset në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi 4 në ditën e fundit të çdo periudhe të këtij interesi dhe interesit të papaguar sipas paragrafit 4 në lidhje me periudhat e mëparshme të intersit do t'i shtohet shumës së interesit përcaktues në fund të çdo periudhe interesi.

Nëse Huamarrësi dështon në pagimin e çdo kostoje ose shpenzimi tjetër për t'iu paguar Huadhënësit në datën kur këto bëhen të pagueshme rregullisht, në përputhje me këtë Marrëveshje, atëherë Humarrësi do të paguajë si shtesë të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë taksat ligjore që lindin nga Huadhënësi për shkak të këtij pagimi të vonuar, ashtu siç përcaktohet nga Huadhënësi.

Gjithashtu Huamarrësi merr përsipër t'i paguajë Huadhënësit të gjithë interesin shtesë dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifat ligjore që lindin dhe të pagueshme nga Huadhënësi, si rezultat i mospërmbushjes nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huadhënësi merr përsipër të informojë Agjentin mbi detajet e llogaritjes së interesit dhe në veçanti të referencës së përdorur për vendosjen e euribor-it nëse është e zbatueshme.

Neni 5

Shlyerja dhe zgjedhja për parapagesën

1. Humarrësi do të shlyejë shumën principale të huasë, në këste vjetore, në datat dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratat e huamarrjes, të cilat do të kryhen në mënyrë të tillë që kësti i parë do të jetë i shlyeshëm në vitin e 11-të (njëmbëdhjetë) të datës përkatëse të pagesës dhe shlyerja përfundimtare do të bëhet në vitin e 15-të (pesëmbëdhjetë) të datës përkatëse të pagesës.

2. Me qëllim që të përfitohen fonde më të lira, Huamarrësi nuk i kërkon Huadhënësit të përfshijë klauzolë për shlyerje të parakohshme në afatet dhe kushtet e huasë. Sidoqoftë, Huamarrësi ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me nenin 5 paragrafi 2 të vendimit, një mundësi shlyerjeje të parakohshme, që kërkon marrjen e një njoftimi me shkrim nga Huadhënësi mbi këtë fakt të paktën 6 ditë-punë përpara datës në të cilin KE-ja ka ndërmend të kryejë një transaksion financiar për huanë. Afatet dhe kushtet e kësaj mundësie shlyerjeje të parakohshme për Huamarrësin do të jenë ato korresponduese të mundësisë për një shlyerje të parakohshme për Huadhënësin sipas kontratave të huamarrjes, që parashikojnë që Huamarrësi të njoftojë Huadhënësin për vendimin e tij për të shlyer para kohe huanë, të paktën një muaj përpara datës së fundit të

njoftimit për shlyerje të parakohshme sipas kontratave të huamarrjes.

Neni 6
Pagesat

1. Të gjitha pagesat që do të bëhen nga Humarrësi, nuk do t'i nënshtrohen pagesës së asnjë takse, komisioni dhe çdo zbritjeje tjetër për të gjithë kohën e kësaj Marrëveshjeje.

2. Humarrësi deklaron që të gjitha pagesat dhe transfertat e bëra në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë vetë Marrëveshjen, nuk i nënshtrohen asnjë takse ose tatimi në vend dhe nuk do t'i nënshtrohen për të gjithë kohën e kësaj Marrëveshjeje. Sidoqoftë nëse Huamarrësi është i detyruar nga ligji për të bërë zbritje të tilla, Huamarrësi do të paguajë shumat shtesë të kërkuara me qëllim që Huadhënësi të marrë shumën e plotë të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

3. Të gjitha pagesat nga Huamarrësi duhet të bëhen në euro në llogarinë në euro të Huadhënësit me Kredietbank S.A.Luksemburg, swift code KBLXLULL, nr.i llogarisë 45 7050 5231 9440 6500 ose në llogari tjetër, sikurse Huadhënësi do të udhëzojë Huamarrësin dhe Agjentin me një njoftim të shkruar të paktën 6 ditë-punë përpara datës përkatëse.

4. Huamarrësi merr përsipër të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të ndodhura dhe të pagueshme nga Huadhënësi për përgatitjen dhe zbatimin e huasë dhe të transaksioneve financiare përkatëse, kontratave të huasë, dhe çdo kosto apo shpenzim që lidhet me transaksionet financiare ose *swaps* nëse ka të tilla, dhe kosto dhe shpenzime përkatëse gjatë kohëzgjatjes së transaksionit financiar, përveç atyre kostove dhe shpenzimeve të shkaktuara nga mospagimi ose të një neglizhence të madhe nga KE-ja. Kostot që lindin nga Huamarrësi, përfshijnë kostot ligjore (p.sh. kostot që shkaktohen për opinionet ligjore), kostot e udhëtimit, komisionet e lidhura me shërbimin financiar të transaksionit financiar, tatimet dhe taksat e regjistrimit, si edhe ato të publikimit nëse do të ketë. Shumat e përmendura më sipër, nëse nuk zbriten nga shumat neto në përputhje me nenin 2 paragrafi 1, do të paguhen nga Huamarrësi brenda një muaji pas njoftimit nga Huadhënësi, njoftim i tillë do të shoqërohet nga dokumente mbështetëse.

5. Nëse Huamarrësi do të paguajë një shumë në lidhje me huanë, e cila është më pak se shuma e përgjithshme përkatëse dhe e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi në këtë mënyrë heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë për të bërë çdo përvetësim të shumës së paguar kundrejt shumave të duhura.

Një shumë e tillë, e paguar nga huaja, do të zbatohet në ose drejt përmbushjes së pagesave të duhura nga kjo hua në radhë të parë në vijim të çdo takse dhe shpenzimi dhe në radhë të dytë të çdo interesi për pagesa të vonuara, siç përcaktohet nga neni 4 paragrafi 4 i Marrëveshjes, së treti kundrejt interesit, së katërti kundrejt principalit, me parashikim se këto shuma janë të duhura ose të vonuara për t'u paguar në atë datë.

Neni 7
Angazhimet lidhur me kontrollet, parandalimin e vjedhjeve dhe auditimet

1. Komisioni, përfaqësuar nga agjentët e tij, ose ekspertët e tij të mandatuar, kanë të drejtën të kryejnë vlerësimet operacionale të procedurave administrative dhe financiare të Huamarrësit dhe të Agjentit, që lidhen me menaxhimin e asistencës makro-financiare të KE-së.

2. Komisioni, përfshirë Zyrën Europiane kundër Vjedhjeve dhe Gjykatën Europiane të Auditorëve, kanë të drejtën të dërgojnë agjentët e tyre ose përfaqësuesit e autorizuar për të kryer kontrolle teknike ose financiare, ose auditime që ata i konsiderojnë të nevojshme lidhur me menaxhimin e kësaj asistence gjatë gjithë periudhës së huasë.

3. Huamarrësi dhe Agjenti do të sigurojnë të gjithë informacionin dhe dokumentet që mund të kërkohen për qëllimin e vlerësimeve, kontrolleve ose auditimeve, dhe të marrin masat e nevojshme për të lehtësuar punën e personave të udhëzuar prej tyre. Huamarrësi dhe Agjenti marrin përsipër t'u japin personave të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 akses në vendet ku ruhet dokumentacioni dhe informacioni.

4. Huamarrësi dhe Agjenti do të kryejnë ekzaminimin dhe trajtimin e duhur të çdo rasti të dyshuar dhe aktual të vjedhjes, korrupsionit ose çdo aktiviteti tjetër ilegal lidhur me menaxhimin e asistencës makro-financiare të KE-së, që është në kundërshtim të interesave financiare të KE-së. Të gjitha këto raste, si dhe masat përkatëse që merren nga autoritetet vendase kompetente do t'i raportohen pa vonesë

Komisionit.

Neni 8
Ngjarjet e mospagesës dhe shlyerjet e parakohshme

1. Huadhënësi, duke i dërguar një njoftim me shkrim Huamarrësit, mund të deklarojë shumën principale të papaguar të Huasë si menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, së bashku me interesat e përfshira dhe të gjitha shumat e tjera të duhura nëse:

a) Huamarrësi do të dështojë për të paguar, në kohën e duhur të përcaktuar, ndonjë pagesë të principalit ose interes qoftë në total, ose në pjesën në mënyrën dhe monedhën e rënë dakord në këtë Marrëveshje, në lidhje me huanë dhe vonesën në pagesë nuk do të shtyhet nga pagesat në vijim brenda 5 ditëve-punë pas njoftimit të shkruar që i është dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

b) Huamarrësi do të vonohet në plotësimin e ndonjë detyrimi tjetër sipas Marrëveshjes, të tjera nga ato të përfshira në memorandum dhe një vonesë e tillë do të vazhdojë për 30 ditë pas njoftimit me shkrim që i është dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi në përputhje me nenin 9; ose

c) për çdo arsye çfarëdoqoftë ajo, si pasojë e një veprimi ose mosveprimi nga një institucion ose individ, ose organ që ka pushtet ligjor brenda territorit të Huamarrësit, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes kundërshtohen si të detyrueshme mbi ose të zbatueshme kundër Huamarrësit; ose

d) është përcaktuar se lidhur me Huanë, Huamarrësi ose Agjenti janë përfshirë në ndonjë veprim vjedhjeje ose korrupsioni ose aktivitet tjetër ilegal në kundërshtim me interesat financiare të KE; ose

e) ka një marrëveshje huaje të mëparshme midis vendit të Huamarrësit, Agjentit dhe një institucioni të KE-së (ky term nënkupton Komunitetin Europian, Komunitetin Europian të Energjisë Atomike, Komunitetin Europian të Gazit (në likuidim), Bankën e Investimeve Europiane dhe çdo agjenci, autoritet, komitet, departament, institucion legjislativ ose zyrë) ose sipas një borxhi huaje të jashtme të vendit të Huamarrësit një deklaratë vonese siç përcaktohet, instrument qeveritar ose që tregon një borxh të tillë dhe si rezultat i kësaj deklarate vonese, ka një përshpejtim të një borxhi të tillë; ose

f) Huamarrësi nuk paguan përgjithësisht borxhet e tij të jashtme brenda kohës ose do të deklarojnë ose imponojnë një moratorium mbi pagesën e borxhit të jashtëm të Huamarrësit ose të një borxhi të jashtëm të supozuar ose të garantuar nga ai.

Për qëllim kuptimin në vijim, "borxh i jashtëm" i Huamarrësit "nënkupton çdo borxh të kontraktuar, garantuar ose ndryshe të siguruar nga Huamarrësi ose Agjenti", e cila është, qoftë e:

i) përcaktuar në një monedhë tjetër nga monedha e Huamarrësit; ose

ii) e rrjedhur ose e ndodhur (në çdo lloj monedhe) jashtë vendit të Huamarrësit.

2. Huadhënësi mundet, por nuk është i detyruar t'i ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij neni, dhe mundet gjithashtu t'i ushtrojë vetëm ato pjesërisht, pa asnjë paragjykim në lidhje me ushtrimin e këtyre të drejtave në të ardhmen.

3. Huamarrësi do të rimbursojë Huadhënësin për të gjitha kostot dhe shpenzimet e kryera, komisione dhe humbje të interesit që lindin dhe janë të pagueshme nga KE-ja si pasojë e një shlyerjeje të parakohshme të huasë sipas nenit 8. Humbja e interesit është diferenca ndërmjet normës së interesit të huasë dhe interesit të përvetësuar nga KE-ja nga riinvestimi i shumave të shlyera përpara kohe për periudhën ndërmjet datës së shlyerjes së parakohshme dhe datës në të cilën transaksioni financiar maturohet ose mund të përfundohet sipas kushteve të kontratave të huasë.

Neni 9
Njoftimet

Të gjitha njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim dhe duhet të dërgohen në:

Për KE-në
Komisioni i Komuniteteve Europiane
Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Çështjeve Financiare
Drejtoria e Operacioneve Financiare, menaxhimi i programeve dhe bashkëpunimi me Grupin e Huamarrjes BEI, programet e Huadhënies dhe Joint Venture
Qendra A.Wagner
L-2920 Luksemburg

Tel: (352) 430133150
Fax: (352) 430136599

Tel: 355 4 228405
Për Huamarrësin Fax: 355 4 228494
Ministria e Financave dhe e Thesarit të Shqipërisë
Ministri i Financave
Arben Malaj
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri

Tel: 355 4 228421
Për Agjentin Fax: 355 4 223558
Banka e Shqipërisë
Guvernatori
Ardian Fullani
Sheshi Skënderbej,nr.1
Tiranë, Shqipëri

Njoftimet për Huamarrësin ose për Agjentin mund të jenë të vlefshme nëse ato dërgohen me shkrim në:

Misioni i Shqipërisë pranë Komuniteteve Europiane, Rue Hottat 42
B-Bruxelles Tel: (32) 2 6403544
Belgium Fax: (32) 2 3403177

Të gjitha njoftimet e dhëna nga Agjenti prezumohet të jenë dhënë për dhe në emër të Huamarrësit, dhe Huamarrësi do të detyrohet njëlloj sikur t'i kishte bërë vetë këto njoftime.

Të gjitha njoftimet do të bëhen me anë të postës së regjistruar, nëse është e praktikueshme. Në rast të kundërt dhe në rast urgjence, ato mund të bëhen me fax, telex, swift ose nëpërmjet letrës së dorëzuar në dorë në adresat e mësipërme dhe të konfirmuara nga posta e regjistruar nëse është e praktikueshme.

Të gjitha dokumentet, informacionet dhe materialet që do të jepen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze ose në gjuhën e vendit të Huamarrësit të shoqëruar nga një përkthim i vërtetuar në anglisht, duke mundësuar që, në rastin e dytë, përkthimi në anglisht do të jetë versioni mbi të cilin Huadhënësi do të ketë të drejtë të bazohet.

Neni 10
Të ndryshme

1. Nëse një ose më shumë dispozita të përfshira në këtë Marrëveshje do të jenë ose do të bëhen plotësisht të pavlefshme ose pjesërisht të paligjshme, ose të pazbatueshme në lidhje me çdo ligj të zbatueshëm, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikohet ose dëmtohet në asnjë mënyrë për këtë shkak. Dispozitat të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, do të zbatohen sipas frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Preambula, vendimi dhe anekset e hyra në fuqi në vijim në lidhje me këtë Marrëveshje, p.sh. kontratat e huasë dhe siç mund të jetë rasti i një ose më shumë marrëveshje shpërndarjeje ose marrëveshje pajtimi, marrëveshje agjencie, ose marrëveshje agjencie fiskale, marrëveshje reklamë dhe marrëveshje shkëmbimi do të formojnë në vijim një pjesë integrale të Marrëveshjes. Titujt dhe nenet e Marrëveshjes janë vetëm për lehtësi referimi.

3. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i kushteve dhe termave mbi bazën e të cilave KE-ja bën të disponueshme për Huamarrësin shumat përkatëse të transaksionit financiar përkatës, të caktuara nga KE-ja për këtë efekt. Për rrjedhojë, Huamarrësi dhe KE-ja pranojnë që të drejtat dhe detyrimet e tyre, përveçse ku parashikohet ndryshe nga Marrëveshja, janë të përcaktuara dhe të interpretuara duke iu referuar dokumentacionit përkatës së huasë. Në veçanti, kushtet e kontratave të huasë do të zbatohen në këtë Marrëveshje. Megjithatë, nëse ka një konflikt ndërmjet termave të kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë kontrate huamarrjeje, do të mbizotërojnë termat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Një "ditë-punë" do të jetë një ditë në të cilën bankat në përgjithësi janë të hapura për aktivitet në vendet përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin anglez.

2. Palët zotohen të paraqesin, në vijim të nenit 238 të traktatit themelues të Komunitetit Europian (Traktati BE), çdo mosmarrëveshje lidhur me ligjshmërinë, vlefshmërinë, interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në juridiksionin dhe gjykimin nga Gjykata e Shkallës së Parë të Komuniteteve Europiane (GJSHP) me të drejtë apelimi te Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane (GJED), përcaktuar në nenin 225 të Traktatit të BE-së.

Gjykimet e GJSHP-së dhe GJED-it, sikurse mund të jetë rasti, do të jenë plotësisht të detyrueshme dhe të zbatueshme nga palët, me përjashtim kur është në gjykim një ankim nga GJSHP-ja dhe GJED-i, në mënyrë të përkohshme, pezullon veprimin e një gjykimi ose të çdo pjese të një gjykimi të GJSHP-së dhe në rastin e Komunitetit Europian, pa cenuar zbatimin e protokollit për privilegjet dhe imunitetet e Komuniteteve Europiane.

3. Huadhënësi mund të zbatojë çdo vendim të marrë të GJSHP-ja ose GJED-i, ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshje ose të drejta të tjera, ndaj Huamarrësit në gjykatën e vendit të Huamarrësit.

4. Nëpërmjet kësaj, Huamarrësi zotohet, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar (1), të heqë dorë nga çdo imunitet që mund të ketë ose mund të fitojë nga juridiksioni dhe ekzekutimi në lidhje me çdo veprim ose procedim të kërkuar në GJED ose GJSHP, ose në gjykatat e vendit të Huamarrësit në lidhje me Marrëveshjen dhe (2) të ekzekutojë me kujdes dhe me mirëbesim çdo vendim që rrjedh nga ndonjë procedim ligjor i ndërmarrë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Në vijim të ekzekutimit të saj, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Huadhënësi ka marrë një njoftim zyrtar nga Huamarrësi që të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe zotimi i vlefshëm dhe i parevokueshëm i Huamarrësit për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje janë plotësuar.

Hyrja në fuqi nuk do të jetë më vonë se 6 gushti 2006. Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi brenda kësaj date, Palët e kësaj Marrëveshjeje nuk do të detyrohen më nga kjo Marrëveshje.

Neni 13

1. Dokumentet e mëposhtme i bashkëngjiten kësaj dhe janë pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

Bashkëlidhur 1: Kontratat huamarrëse

Bashkëlidhur 2: Memorandumi i mirëkuptimit

2. Kjo Marrëveshje do të hartohet nga secila Palë në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe çdonjëra do të konsiderohet si instrument origjinal.

Bërë në Bruksel më 31 maj 2005 dhe në Tiranë 17 maj 2005 në katër kopje origjinale në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të Shqipërisë
Si Huamarrës
Nga Arben Malaj
Ministër i Financave i Shqipërisë
Banka e Shqipërisë
Si Agjent
Nga Ardian Fullani
Guvernator

Nënshkruar për dhe në emër të Komunitetit Europian
Përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane
Si Huadhënës
Nga Joaquin Almunia
Anëtar i Komisionit

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Në 29 prill 2004, Këshilli i Komunitetit Europian miratoi një vendim për të bërë të vlefshme për Republikën e Shqipërisë (që tani e tutje referohet si "Vendi") një asistencë makrofinanciare deri në 25 milionë euro, e përbërë nga një lehtësirë huaje deri në 9 milionë euro (huaja) dhe një lehtësirë granti deri në 16 milionë euro (Granti) (vendimi 2004/580/KE). Objektivi i kësaj asistence është të zbusë vështirësitë e financimeve të huaja të vendit, të mbështesë bilancin e pagesave dhe të fuqizojë poziconin e rezervave të këmbimit të huaj. Asistenca nga Komuniteti Europian është plotësues i burimeve të siguruara për Vendin nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët bilateralë në mbështetje të stabilizimit ekonomik të autoriteteve dhe programit të reformave.

2. Asistenca do të disbursohet në të paktën dy këste. Disbursimi i asistencës do të kushtëzohet nga ecuria e pëlqyeshme në zbatimin e marrëveshjes aktuale ose marrëveshjeve pasuese të rëna dakord ndërmjet Vendit dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), si dhe nga vlerësimi pozitiv nga Komisioni Europian (që tani e tutje i referohet si "Komisioni"), në emër të Komunitetit Europian, nga ecuria e bërë në lidhje me stabilizimin ekonomik dhe reformat strukturore.

Kushtet makroekonomike dhe politika e rregullimeve strukturore të bashkëngjitura kësaj asistence bazohen në stabilizimin ekonomik dhe programin e reformave të nënshkruara nga autoritetet e vendit dhe që janë në përputhje me marrëveshjet e arritura nga vendi me FMN-në.

Kriteret sasiore të performancës bashkëngjitur asistencës së Komunitetit do të jenë ato të specifikuara në Marrëveshjen aktuale për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike ose në marrëveshje pasuese të rëna dakord ndërmjet Vendit dhe FMN-së. Përpara disbursimit të çdo kësti të kësaj asistence, Komisioni, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe stafin e FMN-së, do të verifikojnë se kriteret sasiore të performancës janë respektuar siç duhet ose është rënë dakord për kuptime të reja. Kriteret aktuale sasiore përmbajnë:

i) kufij tremujorë për aktivet neto të brendshme të Bankës së Shqipërisë (BSH);

ii) kufij tremujorë për kredinë neto të sistemit bankar për qeverinë qendrore të konsoliduar;

iii) objektiva treguese tremujore të të ardhurave totale nga taksat;

iv) tavanë tremujorë për rezervat neto ndërkombëtare të BSH-së;

v) kufij tremujorë për kontraktimin ose garantimin e borxhit të jashtëm publik jokoncesional dhe publik i garantuar.

3. Për shumat e sakta dhe kohën e disbursimit të secilës transhe do të bihet dakord nga të dyja palët në kuadër të Grantit dhe/ose marrëveshjeve të huasë. Disbursimi i dytë dhe kështet e mëpasme nuk do të bëhen përpara të paktën tre muaj pas disbursimit të kështit të mëparshëm.

Në përcaktimin e shumave që do të disbursohen nga kjo asistencë, do të merret në konsideratë mobilizimi i efektshëm i asistencës financiare ndaj vendit nga donatorë të tjerë dhe ecuria e nevojave financiare.

Pas marrjes së njoftimeve të përputhshmërisë nga autoritetet e Vendit dhe përpara pagesës së çdo kësti, Komisioni do të vlerësojë, në bashkëpunim me autoritetet e Vendit, ecurinë e bërë lidhur me përmbushjen e kritereve sasiore të performancës dhe një numër të përzgjedhur të kritereve të reformave strukturore. Në këtë vlerësim, vëmendje e veçantë do t'i jepet reformës së financave publike dhe administrimit, reformave në sektorin bankar dhe zhvillimin e sektorit privat. Kuadri referues për këtë vlerësim jepet shprehimisht në shtojcën I. Mund të rregullohet në një fazë të mëvonshme.

4. Pagesa e efektshme e kësteve të ndryshme do të jetë subjekt i nënshkrimit të angazhimeve ligjore përkatëse (Marrëveshje granti/huaje) nga palët. Kështet e grantit do të jenë subjekt i vendimit të autoritetit buxhetor të KE-së për të bërë të vlefshme shumat e nevojshme.

5. Komisioni do të bëjë të vlefshme shumat e huasë dhe grantit te Banka e Shqipërisë (BSH) që vepron si agjent i Vendit ose tek institucioni ose institucionet e caktuara për të marrë përgjegjësinë nga BSH-ja për marrjen e fondeve në kontekstin e kësaj asistence makro-financiare komunitare.

Autoritetet e Vendit marrin përsipër të përmbushin në kohën e duhur dhe plotësisht të gjitha detyrimet financiare që burojnë nga huatë e siguruara ose të garantuara nga Komuniteti Europian.

Gjatë zbatimit të asistencës, autoritetet e Vendit do t'i sigurojnë Komisionit të gjithë informacionin përkatës, lidhur me monitorimin e situatës financiare dhe ekonomike dhe që do të jetë e nevojshme për vlerësimin e kritereve sasiore të performancës dhe për rishikimin e ecurisë së reformave strukturore. Në veçanti, autoritetet do t'i japin Komisionit, mbi baza tremujore, informacionin përkatës siç përcaktohet në shtojcën II.

6. Komisioni, i përfaqësuar nga agjentët e tij ose ekspertët e duhur të mandatuar do të kenë të drejtën të kryejnë vlerësimet operative të procedurave administrative dhe të rrjetit financiar të Vendit dhe të agjentit lidhur me menaxhimin e asistencës makrofinanciare komunitare.

7. Një vlerësim i pavarur *ex-post* i asistencës mund të kryhet nga Komisioni ose përfaqësuesit e duhur të autorizuar. Autoritetet e Vendit janë të angazhuar të japin të gjithë informacionin e nevojshëm sipas rastit. Raporti i vlerësimit do të bëhet i vlefshëm për ta për komente.

8. Autoritetet do të sigurojnë, në mënyrë të duhur, bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Europian.

9. Asistenca zbatohet me kuptimin që autoritetet e Vendit do të vazhdojnë të respektojnë rregullën e ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

10. Sipas vendimit të Këshillit të KE/2004/580 të 29 prillit 2004, kjo asistencë do të zbatohet deri në 6 gusht 2006.

11. Shtojcat I dhe II janë pjesë përbërëse e këtij memorandumi.

12.Të gjitha njoftimet lidhur me memorandumin aktual do të jepen me shkrim dhe dërgohen te:

Për Komunitetin Europian	Komisioni i Komunitetit Europian Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Financiare dhe Ekonomike Rue de la Loi, 200-bu-1 1/57, b-1049 Bruksel Nr.faksi (+32-2)299 61 51
Për Vendin	Ministri i Financave Arben Malaj Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, Shqipëri Nr.faksi:+355 4 22 8494
Për Bankën Kombëtare të Vendit	Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Sheshi "Skënderbej" nr.1 Nr.faksi +355 4 22 3558

Bërë në Bruksel në gjuhën angleze_____2005 dhe në Tiranë në _____2005 në katër kopje origjinale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Përfaqësuar nga

Arben Malaj
Ministër i Financave

KOMUNITETI EUROPIAN
Përfaqësuar nga

Joaquin Almunia
Anëtar i Komisionit Europian

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË
Ardian Fullani
Guvernator i Bankës së Shqipërisë

SHTOJCA I
KRITERET E REFORMAVE STRUKTURORE

1. Veprimet për t'u ndërmarrë nga Ministria e Financave përpara disbursimit të këstit të parë për të thelluar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit financiar dhe kontrolleve administrative.

- Për thesarin, qartësimi dhe formalizimi i delegimit të autoritetit nga niveli (nivel i cili mund të kërkojë, miratojë, urdhërojë, marrë, paguajë, rakordojë, për cilën lloj shpenzimesh, deri në cilën shumë) dhe të sigurojë ndarjen e duhur të detyrave. Stafi i cili kryen pagesat nuk do të ketë detyrë për të miratuar pagesat ose rakorduar shumat.
- Të zbatojë firmosjen e dyfishtë të pagesave nga thesari.

2. Në kohën kur Komisioni rishikon se do t'i paraprijë vendimit lidhur me disbursimin e këstit të dytë, autoritetet janë të angazhuara të kenë arritur ecuri në fushat e mëposhtme:

Masat për të thelluar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit financiar dhe kontrolleve administrative dhe për të përmirësuar menaxhimin e financave publike.

- Dërgim tremujor nga Ministria e Financave te Këshilli i Ministrave të raporteve të auditit të brendshëm të ministrive të linjës, së bashku me rekomandimet për rregullimin e veprimeve në fushat e

identifikuara.

- Miratim i letërpolitikës për kontrollin e brendshëm të financave publike.

- Ecuri në futjen e sistemit të ri të integruar të IT për të mbështetur aktivitetet bazë të thesarit. Në veçanti, fillimi i operacionit të trefishtë në distriktin e Tiranës.

Masat për të përmirësuar funksionimin e administratës publike dhe luftës kundër korrupsionit.

- Procedimi i pagesës në të paktën 50% të pagave të sektorit publik nëpërmjet sistemit bankar.

- Miratimi* i kuadrit ligjor mbi konfliktin e interesave.

- Miratimi i masave ligjore për të kufizuar vonesat në procesin gjyqësor.

Reforma e sektorit financiar

- Miratimi i ligjit të ri për sektorin bankar.

- Futja te Banka e Shqipërisë e një sistemi *software* të integruar dhe zbatimi gjatë gjithë vitit 2005 i planit të mbikëqyrjes bankare.

- Miratimi i akteve nënligjore për sigurimet/risigurimet, përfshirë rregulla të kujdesshme lidhur me risigurimin.

Masat për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të përshpejtuar zhvillimin e sektorit privat.

- Miratimi i planit të ri të veprimeve mbi heqjen e barrierave administrative.

- Miratimi i ligjit të ri mbi regjistrimin tregtar me qëllimin e lehtësimit të futjes në treg.

- Ofrimi për shitje (tenderi përfundimtar) i Albtelekomit dhe ARMO-s.

SHTOJCA II
SISTEMI I MONITORIMIT

Gjatë zbatimit të asistencës komunitare, treguesit në vijim dhe raportet do të bëhen të vlefshme për Komisionin nga autoritetet përkatëse mbi baza tremujore.

1. Monitorimi i zhvillimeve makroekonomike dhe financiare, dhe politikave

- PBB ose të ardhurat kombëtare (të dhëna vjetore ose tremujore kur të jenë të vlefshme).
- Komponentët kryesorë të PBB (të dhëna vjetore)
- Prodhimi industrial (mujor)
- Pagat mujore
- Përqindja e punësimit dhe e papunësisë (mujore)
- Treguesit e çmimeve (mujorë)
- Normat e interesave afatshkurtra (mujore)
- Niveli dhe përbërja e të ardhurave qeveritare dhe shpenzimeve, si dhe detyrimeve të prapambetura qeveritare (niveli i qeverisjes qendrore, mujore)
- Tregtia e jashtme (mujore)
- Bilanci i pagesave (tremujor)
- Pozicioni i rezervave ndërkombëtare (mujore)
- Kurset e këmbimit valutor (javore)
- Borxhi i jashtëm (tremujor) përfshirë detyrimet e prapambetura të jashtme (tremujore)
- Pagesat e shërbimit të borxhit (tremujore)

2. Monitorimi i politikave strukturore:

- Raport progresi i reformës së financave publike dhe administrative;
- Raport progresi i reformës në sistemin bankar;
- Raport progresi i zhvillimit të sektorit privat.

* "Miratimi" duhet të kuptohet në shtojcën aktuale si "Miratim qeveritar"